

**Libra dhe media të tjera në më shumë se 50 gjuhë  
Mirë se vini në Bibliotekën St. Johann JUKIBU!**

**Për kë është biblioteka?**

Për të gjithë: fëmijët, adoleshentët, të rriturit.

Nëse dëshironi të huazoni libra ose media, blini një kartelë biblioteke. Kartela e bibliotekës është e vlefshme për të gjitha bibliotekat e GGG Stadtbibliothek Basel dhe për bibliotekën tonë dixhitale.

Ju mund të vizitonи bibliotekën edhe pa kartelë biblioteke.

Shumë aktivitete zhvillohen në gjuhë të ndryshme.

Ne kemi WiFi, PC, printerë, stacione pune dhe dhoma në grup, gazeta dhe revista.

Ushqimi dhe pijet janë të lejuara.

**Si mund të pajisem me një kartelë biblioteke për huazim?**

Personelit të bibliotekës duhet t' i tregoni një dokument identifikimi me fotografi. Punonjësit tanë do t'ju shpjegojnë me shumë kënaqësi opsonet e ndryshme, rregullat dhe tarifat. Kartelat janë falas për fëmijë.

Të gjitha informacionet i gjeni këtu: [www.stadtbibliothekbasel.ch](http://www.stadtbibliothekbasel.ch)

**Sa media mund të huazoj?**

Maksimumi deri në 15.

**Sa kohë mund t'i mbaj mediat?**

Zakonisht një muaj. Datën e kthimit e gjeni në faturën e huazimit ose nëse kyçeni në llogarinë tuaj me kartelen e bibliotekës. Keni nevojë për më shumë kohë? Zakonisht janë të mundshme zgjatjet e kohës së mbajtjes së mediave të huazuara deri në tre muaj.

Mediat mund t'i ktheni në çdo bibliotekë të GGG.

Nëse mediat i ktheni me vonesë, do të paguani një tarifë vonese.

**Kam humbur kartelën time të bibliotekës, çfarë të bëj?**

Na raportoni humbjen menjëherë. Bllokimi i kartelës është falas. Kartela zëvendësuese është me pagesë. Në rast se kartela është pështjellur diku, atëherë personelit të bibliotekës duhet t' i tregoni një kartë identiteti me një fotografi për të huazuar media. Kartelen tuaj mund ta regjistroni në aplikacionin GGG Stadtbibliothek Basel.

**Rregulla të rëndësishme**

Ne duam që të gjithë njerëzit të ndihen rehat te ne. Shmangni mbeturinat dhe zhurmat dhe tregoni respekt ndaj vizitorëve të tjerë.

Ju lutemi përdorni me kujdes mediat. Në rast dëmtimi ose humbjeje, do të paguani një tarifë. Mos e blini vetë zëvendësimin.

**Renditja**

Dëshironi të ktheni librin dhe nuk jeni të sigurt se ku të shkoni? Sillni librin në banak ose vendoseni në një tavolinë ose stol.

Për lojërat e tavolinës vlen: ju lutemi vendosni të gjitha pjesët në kutinë përkatëse.

**A keni pyetje tjera?**

Ne jemi një ekip shumëgjuhësh dhe ju ofrojmë informacione me shumë kënaqësi.

Biblioteka St. Johann JUKIBU, Lothringerplatz 1, 4056 Basel, 061 322 63 19, [stjohannjukibu@stadtbibliothekbasel.ch](mailto:stjohannjukibu@stadtbibliothekbasel.ch)

